



AZHBR: Kësti i dytë për 65 mijë fermerë përfitues të skemës kombëtare kaloi më 31 dhjetor

Faqe 2



Zgjerim i bashkëpunimit në bujqësi dhe zhvillim rural me Egjiptin

Faqe 2



Kompensim 10% të TVSH-së për fermerët nga 1 janari

Faqe 2



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit janar 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 525
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

REZOLUTA MBËSHTET 4 SHTYLLA KRYESORE REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në përfundim të Kongresit të V, miratoi Rezolutën Kombëtare për Agrobiznesin, e cila përcakton prioritetet strategjike dhe masat që kërkojnë bashkërendim mes qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve të zhvillimit. Qëllim kryesor përmirësimi i cilësisë dhe standardeve në zhvillimin rural dhe agroushqimor të vendit

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

ALBANIA

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

UBT

Sallaku: Mbi 1400 fermerë të trajnuar nga UBT, monitorim mbi 45 fermave model

Faqe 4



TEKNOLOGJI



Prezantohet metodologjia pilot e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës

TEMA TË DITËS

Faqe 4

- Autoriteti i Konkurrencës, analizë krahasuese të ecurisë së çmimeve për produktet e shportës Fq.4
- Rama: "EuroAgro Albania", kanal i hapur dialogu për fermerët dhe bizneset drejt anëtarësimit në BE Fq.5
- Bashkia e Korçës do të ngrejë fermë model për kultivimin dhe ambalazhimin e mollëve Fq.5
- Zv.ministri Guri: Vijon evidentimi i dëmeve nga përmbytjet Fq.6
- 10 fabrika të përpunimit të ullirit në Finiq, asnjë prodhues nuk e ka të certifikuar vajin Fq.6
- Deformimet me figura të çuditshme të frutave dhe perimeve - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Ngricat pas përmbytjeve rrafshojnë prodhimin bujqësor



Faqe 12

FINANCIM

Skema e investimeve, 27 shkurti afati i fundit për dokumentet - Nga rrjetat antibreshër, tek serrat diellore dhe agroturizmi. Deri 150 mijë euro financim



Faqe 2

TEMA TË DITËS

AZHBR: Kësti i dytë për 65 mijë fermerë përfitues të skemës kombëtare kaloi më 31 dhjetor

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) informon fermerët se kësti i dytë i pagesave në kuadër të Skemave Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2025, është kryer brenda datës 31 dhjetor 2025, në përputhje me procedurat financiare në fuqi.

Fondet përkatëse tashmë janë transferuar në bankat e nivelit të dytë dhe po kalohen gradualisht në llogaritë bankare të fermerëve përfitues.

Me miratimin e Aktit Normativ, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Për buxhetin e vitit 2025, të ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare, buxhetit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural i është shtuar fondi prej 1,960,406,000 lekësh.

Ky fond i shtuar është i des-

tinuar për kryerjen e pagesave në kuadër të Skemave Kom-

kare të rreth 65,000 fermerëve përfitues, përmes bankave të



bëtare të Mbështetjes, masat 1-8, për vitin 2025.

AZHBR bën të ditur se, ka punuar pa ndërprerje në ditët e fundit të vitit për të mundur kalimin e 50% të mbetur të pagesave, të cilat po shpërndahen aktualisht në llogaritë ban-

nivelit të dytë.

AZHBR falënderon fermerët për bashkëpunimin dhe durimin e treguar dhe mbetet e angazhuar që edhe në vijim të garantojë mbështetje për sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural.

Kompensim 10% të TVSH-së për fermerët nga 1 janari

Nga data 1 janar 2026 ka nisur zbatimimi i skemës së kompensimit të TVSH-së 10%

në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', i

mbi vlerën e faturave të lëshuara nga blerësi i produkteve të tyre bujqësore.

Për fermerët e pajisur me NIPT tatimor, pra që nuk janë subjekte të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), ligji parashikon se fatura e shitjes apo autofatura lëshohet prej blerësve të mallrave bujqësore.

Në total, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, nga viti 2018 deri në shtator 2025 janë të pajisur me NIPT tatimor 110 mijë fermerë.

Ky është një hap strategjik në mbështetje të fermerëve dhe prodhimit vendas, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë shqiptare në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.



për fermerët që do të shesin prodhimet e tyre bujqësore tek grumbulluesit, përpunuesit apo agroturizmet e certifikuar.

Ligji "Për disa ndryshime

ndryshuar" i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pjesë e paketës së re fiskale 2026, përcakton se kompensimi i TVSH-së 10% të fermerëve do të bëhet

Fermerët që kanë aplikuar për Skemën e Investimeve, do të kenë afat deri më datën 27 Shkurt 2026 për të dorëzuar dokumentacionin plotësues të dosjes së tyre.

Përmes një udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave, qeveria ka vendosur këtë datë si afat përfundimtar, ndërsa udhëzimi i mëparshëm lejonte një hapësirë prej 60 ditë pas përfundimit të aplikimit.

Po ashtu, në udhëzim përcaktohet se dorëzimi i dokumenteve përtej datës 27 shkurt 2026, do të skualifikojë aplikantët dhe në këtë pikë përjashtohet vetëm dokumenti i lejes së ndërtimit apo miratimit të njoftimit të punimeve/kontratës së lidhur me MBZHR, për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës për masën 17 e

cila duhet të paraqitet para lidhjes së kontratës.

Më 30 shtator u mbyllën aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve në Bujqësi 2025, me gjithsej 801 aplikime të regjistruara për nëntë masa mbështetëse që synojnë modernizimin e fermave, rritjen e prodhimit vendas dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

Konkretisht, financimi më i lartë do të jepet për ndërtimin e serrave diellore të reja për perime, luleshtrydhe dhe rrush tavoline, përfshirë edhe instal-

imin e sistemit të ujitjes, me sipërfaqe minimale 0.2 ha dhe sipërfaqe maksimale 2 ha.

Për këtë masë financimi nis nga 40 mijë euro për ha luleshtrydhet deri në 150 mijë euro/ha për serat e prodhimit të perimeve apo 50% të vlerës totale të faturave tatimore.

Për investime në mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave, financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha, masa e përfitimit arrin deri në 8 mijë euro për hektarë.

Rrjeta për mbrojtjen e pro-

Zgjerim i bashkëpunimit në bujqësi dhe zhvillim rural me Egjiptin

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Guri, zhvilloi një takim me ministrin e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit

Ndërkombëtar të Republikës së Egjiptit, Rania Al-Mashat, ku u diskutuan mundësitë për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh në

fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë takimit, palët theksuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në transferimin e teknologjive moderne dhe praktikave më të mira për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe në promovimin e kultivimit të qëndrueshëm bujqësor.

Vëmendje e veçantë iu kushtua rritjes së produktivitetit në nivel ferme dhe ofrimit të këshillimit e mbështetjes teknike për fermerët.

Gjithashtu, u diskutua zgjerimi i shkëmbimeve tregtare, veçanërisht për produktet bujqësore, si një hap konkret drejt forcimit të marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Egjiptit.

Delegacionet e të dy vendeve gjatë takimit në Tiranë shprehën gatishmërinë për të intensifikuar bashkëpunimin institucional dhe për të ndërtuar iniciativë të përbashkëta që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në të dy vendet.



Tatimpaguesit do të aplikojnë online për shmangien e tatimit të dyfishtë

Administrata Tatimore informon të gjithë tatimpaguesit se, duke filluar nga 1 janari 2026, procedura për zbatimin e marrëveshjes për eliminimin e tatimit të Dyfishtë do të kryhet ekskluzivisht online, përmes platformës digjitale të Administratës Tatimore.

Tatimpaguesit duhet të plotësojnë formularin elektronik përkatës dhe të ngarkojnë dokumentacionin shoqërues, sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të

përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe aktet nënligjore përkatëse. Ngarkimi elektronik i dokumentacionit duhet të bëhet brenda afateve ligjore, për të përfutur lehtësitë tatimore që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë.

Në rastet kur sistemi digjital nuk mundëson përkohësisht ngarkimin elektronik të dokumentacionit ose paraqiten probleme teknike të verifikuar, tatimpaguesit

kanë të drejtë të dorëzojnë dokumentacionin në formë fizike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke shpjeguar arsyen e pamundësisë së dorëzimit elektronik.

Administrata Tatimore fton tatimpaguesit të informohen paraprakisht mbi mënyrën e përdorimit të platformës dhe dokumentacionin e nevojshëm, duke përdorur udhëzuesin zyrtar të publikuar në faqen e YouTube të Administratës Tatimore.

Skema e investimeve, 27 shkurti afati i fundit për dokumentet - Nga rrjetat antibreshër, tek serrat diellore dhe agroturizmi. Deri 150 mijë euro financim

cila duhet të paraqitet para lidhjes së kontratës.

Më 30 shtator u mbyllën aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve në Bujqësi 2025, me gjithsej 801 aplikime të regjistruara për nëntë masa mbështetëse që synojnë modernizimin e fermave, rritjen e prodhimit vendas dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

Konkretisht, financimi më i lartë do të jepet për ndërtimin e serrave diellore të reja për perime, luleshtrydhe dhe rrush tavoline, përfshirë edhe instal-

imin e sistemit të ujitjes, me sipërfaqe minimale 0.2 ha dhe sipërfaqe maksimale 2 ha.

Për këtë masë financimi nis nga 40 mijë euro për ha luleshtrydhet deri në 150 mijë euro/ha për serat e prodhimit të perimeve apo 50% të vlerës totale të faturave tatimore.

Për investime në mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave, financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha, masa e përfitimit arrin deri në 8 mijë euro për hektarë.

Rrjeta për mbrojtjen e pro-

dhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta, masa e përfitimit arrin deri në 15 mijë euro/hektarë. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 ha dhe jo më shumë se 5 ha.

Për sistemet e ujitjes me pika në pemëtore, ullishte, agrume dhe vreshta ekzistues, financimi arrin deri në 2500 euro/ha.

Për ndërtimin e ambienteve të reja për mbarëshkrimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, financimi arrin deri në 150 mijë euro për subjekt.

Për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit arrin në 50 mijë euro për subjekt.

Mbështetja për linja/makinëri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit arrin në afro 75 mijë euro për subjekt

Mbështetja për investime në agroturizëm do të jetë deri në 150 mijë euro për subjekt dhe po ashtu për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshku.

Për të përfutur nga këto masa mbështetëse, aplikanti: -nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së dhe MBZHR-së; -nuk duhet të jetë debitor ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ketë shlyer "sigurimet shoqërore" në rastin e fermerëve individualë; të ketë tokën në pronësi dhe/ose me qira/huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit; të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës.

Përfituesve nga masat e mbështetjes së investimeve, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së pagesës së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka, sipas përcaktimeve të kontratës.

REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në përfundim të Kongresit të V, miratoi Rezolutën Kombëtare për Agrobiznesin, e cila përcakton prioritetet strategjike dhe masat që kërkojnë bashkërendim mes qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve të zhvillimit. Qëllim kryesor përmirësimi i cilësisë dhe standardeve në zhvillimin rural dhe agroushqimor të vendit

QËLLIMI DHE KONTEKSTI I REZOLUTËS
Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në përfundim të punimeve të Kongresit të V-të, miraton këtë **Rezolutë Kombëtare për Agrobiznesin Shqiptar**, me qëllim përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe masave që kërkojnë bashkërendim të menjëhershëm mes qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve të zhvillimit. Rezoluta bazohet në katër shtyllat themelore të zhvillimit të sektorit:

Kooperimi dhe Koordinimi, Mekanizimi, Inovacioni dhe dixhitalizimi, Financimi dhe Disbursimi i Fondeve Grant, Legjislacioni dhe Përafrimi me BE-në.
Këto përbëjnë boshtin kryesor mbi të cilin KASH ndërton kontributin e tij në zhvillimin rural dhe agroushqimor të vendit me synim kryesor **përmirësimin e cilësisë dhe standardeve.**

I. PROCESI I KOOPERIMIT DHE KOORDINIMIT

Sfidat aktuale
Fragmentarizimi i tokës (1.8 milionë parcela nga Ligji nr. 7501/1991) dhe mosfunksionimi efektiv i Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) dhe strukturave të tjera të ngjashme klasterat, njësitë e shërbimit, etj., kanë dëmtuar procesin e kooperimit dhe bashkëpunimit.

Ligji nr. 38/2012 “Për SHBB” ka rezultuar i paefektshëm edhe për shkak të mungesës së një strukture të posaçme në MBZHR, informalitetit, konkurrencës së pandershme dhe barrës së lartë fiskale. 104 SHBB-të e krijuara janë penalizuar me gjoba nga administrata tatimore, pa marrë parasysh fazën e parë të konsolidimit të tyre.

Propozimet e KASH
1. **Ngritja e një Sektroti ose Drejtorie të Veçantë për Kooperimin** në strukturën e MBZHR-së.
2. **Falja e menjëhershme e gjobave dhe kamatëvonesave** për 104 SHBB-të, si masë besimi për rimëkëmbjen e kooperimit.
3. **Krijimi i një Regjistri të Ri Kombëtar për ndjekjen e veprimtarisë të Subjekteve të Agrobiznesit** në bashkëpunim me QKB.
4. **Hartimi i kurrikulave të posaçme** për trajnimin e drejtuesve të SHBB-ve, klasterave, organizatave të tjera prodhuese, ato të shërbimit dhe Grupeve Vendore të Veprimit (GVV), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit.
5. **Mbështetje veprimtarisë së realizuar përmes kontratave dhe krijimi i strukturës së arbitrazhit për gjykimin e mosmarrëveshjeve.**

Masat e Qeverisë (Status 2025)
• MBZHR dhe FAO kanë nisur **rishikimin e Ligjit 38/2012**, në proces konsultimi publik, por pa afat përfundimi.
• Nuk ka **akt për amnisti fiskale** për SHBB-të dhe subjektet që grantet e donatorëve janë kthyer në kredi me interesa.
• Sistemi i ri i **regjistrimit të fermerëve dhe grupeve ekonomike** është në diskutim teknik për integrim në QKB. Por pa një afat përfundimi.
• Qeveria ka shpallur **paketën “Zhvillimi i zonave malore”** që përfshin stimuj fiskalë për bashkëpunim në zonat e vështira.

II. MEKANIZIMI, INOVACIONI DHE DIGJITALIZIMI

Sfidat aktuale
Sektori i bujqësisë vuan nga mungesa e mekanizimit modern dhe parku i amortizuar i mjeteve (mbi 80 % e parkut është pa targa, pa leje qarkullimi, pa kolaudim, pa sigurim, si dhe mbi 25 vjet përdorim). Shqipëria ka vetëm **1.24 traktorë për 100 ha**, kundrejt mesatares së BE-së prej 8.1 traktorë.
Mungesa e regjistrit kombëtar dhe pamundësia për përdorimin e mjeteve si kolateral e thellojnë informalitetin dhe koston e prodhimit.

Propozimet e KASH
1. **Krijimi i Librit Kombëtar të Mekanikës Bujqësore**, si bazë për regjistrim, kolateral dhe sigurim.
2. **Pajisja e drejtuesve të mjeteve bujqësore me leje qarkullimi dhe targa** (amendim në Kodin Rrugor).
3. **Përmirësimi i Ligjit nr. 62/2012 “Për Akcizat”**, për të mundësuar karburant me çmim të reduktuar për subjektet bujqësore.

4. **Mbështetja e Qendrave të Agroservisit** për importin dhe përshtatjen e makinerive moderne.
5. **Hartimi një strategjie sektoriale për dixhitalizimin e 1.8 milion parcelave**
6. **Hartimi dhe zbatimi i një projekti pilot për përdorimin e dronëve në bujqësi.**
7. **Hartimi dhe zbatimi i një projekti pilot për Serrën e Arki-medit si një risi në bujqësi, energji dhe kibernetikë.**

Masat e Qeverisë (Status 2025)
• Në zbatim është **skema e subvencionimit 50% për makineritë bujqësore** (VKM nr. 485/2025).
• **Regjistri Kombëtar i Mekanikës** nuk është ende miratuar me akt ligjor.
• Qeveria ka sinjalizuar se do të përfshijë këtë mekanizëm në **Paketën e Bujqësisë 2026**.
• KASH propozon shumëvjeçarizimin e skemës dhe integrimin e të dhënave në sistemet fiskale për përdorim si garanci financiare.

III. FINANCIMI DHE DISBURSIMI I FONDEVE GRANT

Sfidat aktuale
Financimi i bujqësisë mbetet nën nivelin minimal te nevojshëm. Buxheti publik për bujqësinë përbën vetëm **1.8–2.1% të shpenzimeve kombëtare**, ndërsa kreditimi nga bankat nuk kalon 2% të totalit.
Ne vendet e rajonit financimi varion nga 3- 4% . Programet e BE-së (IPARD II dhe III) kanë hasur vonesa në disbursim dhe mungesë transparence për fermerët per afatin e fillimit te disbursimit.

Propozimet e KASH
1. **Nisja e disbursimeve të IPARD III** brenda 6-mujorit të parë të 2026.
2. **Dyfishimi i Skemës Kombëtare të Mbështetjes** dhe kalimi në financim për njësi prodhimi për produktet premio dhe të cilësisë së parë,
3. **Trajtimi i mikrofinancave (p.sh. FED Invest)** në të njëjtin nivel me bankat e nivelit të dytë për Garancinë Sovrane.
4. **Modeli i ri i kolateralit** – ku kontratat e furnizimit dhe prodhimet e magazinuara të shërbejnë si garanci.
5. Të programohet dhënie asistence në përgatitjen e dokumenteve për disbursimin e fondeve grant dhe kredive me kushte lehtësuese.

Masat e Qeverisë (Status 2025)
• Është shpallur **linja 250 milionë euro për NVM-të dhe Garancia Sovrane 30 milionë euro**. Skema për mbështetjen e investimeve me 20 mlion euro ku 50% është grant.
• Përfshirja e plotë e mikrofinancës ende **nuk është formalizuar** me akt të veçantë nga BSH.
• **IPARD III** pritet të fillojë në 2026 pas auditit të BE-së.
• Skema Kombëtare 2025 duhet te rritet; KASH kërkon **rritje me 100% në 2026**.

IV. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE PËRAFRIMI ME BE

Sfidat aktuale
Procesi i përafrimit të legjislacionit me acquis communautaire mbetet i ngadalshëm.
Kërkesat e KASH për ndryshimin e ligjeve themelore (për kooperimin, akcizat, TVSH-në, zhvillimin rural dhe standardet) janë trajtuar pjesërisht dhe pa kalendar zbatimi.

Propozimet e KASH
1. **Amendimi i Ligjit nr. 38/2012 “Për SHBB”** (riformulim i plotë).
2. **Amendimi i Ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH”**, për unifikim të pagesës dhe rimbursimit.
3. **Amendimi i Ligjit nr. 62/2012 “Për Akcizat”** (karburanti bujqësor).
4. **Amendimi i Ligjit nr. 9817/2007 “Për Zhvillimin Rural”**, për të mundësuar bashkëpunimin publik–privat.
5. **Hartimi i Ligjit të ri për Sigurimin e Pronës dhe Prodhimit Bujqësor.**
Masat e Qeverisë (Status 2025)

• Rishikimi i **Ligjit 38/2012** është në proces konsultimi me FAO.
• **Kompensimi 10% i TVSH-së për fermerët** është përfshirë në **Paketën Fiskale 2026**, me **efekt zbatimi nga janari 2026**.
• **Ligji për sigurimet bujqësore** është në përgatitje, me synim pilotimin në 2026.
• Nuk ka nismë për **faljen e detyrimeve të prapambetura të fondeve grant**.

V. KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME
Kongresi i V-të i KASH riafirmon rolin e tij si platformë e përbashkët e agrobiznesit shqiptar dhe partner strategjik i institucioneve shtetërore për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe agroindustrisë.
Qartësimi i afateve të zbatimit dhe instrumenteve mbështetëse është thelbësor që propozimet e KASH të mos mbeten deklarative, por të përkthehen në **rezultate të matshme në fermë dhe industri**.

REZOLUTA E KONGRESIT TË V-TË TË KASH (Kërkesa për Veprim të Menjëhershëm)

1. URGJENCË FINANCIARE DHE FISKALE
• Falja e gjobave dhe kamatëvonesave për 104 SHBB-të.
• Fillimi i financimit për njësi prodhimi në Skemën Kombëtare 2026.
• Përfshirja e plotë e mikrofinancës në Garancinë Sovrane dhe Fondin e BSH.
• Zhbllokimin e fondeve IPARD III

2. URGJENCË LEGJISLATIVE
• Trajtimi me urgjencë në Kuvend i paketës së amendimeve ligjore (Ligjet 38/2012, 92/2014, 62/2012, 9817/2007).
• Hartimi i **Ligjit të ri për Sigurimin e Prodhimit dhe Pronës**, me miratim brenda vitit 2026.

3. PRIORITET IPARD III
• Fillimi i disbursimit të fondeve brenda 6-mujorit të parë të 2026.
• Publikimi i kalendarit të thirrjeve dhe raportim publik për transparencë.

4. REFORMË E STRUKTURAVE DHE KOORDINIMIT
• Ngritja e strukturës së posaçme për kooperimin në MBZHR.
• Funksionalizimi i **Librit Kombëtar të Mekanikës Bujqësore** dhe **Qendrës së Regjistrimit të Fermerëve**.
• Thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit për kualifikimin e drejtuesve të grupeve.

INDIKATORË MONITORIMI (2026)
• **TVSH:** ≥80% e kërkesave të rimbursimit të fermerëve paguhen brenda 30 ditësh.
• **IPARD III:** ≥35% e fondeve të thirrjeve 2026 kontraktohen brenda vitit.
• **Mekanizim:** ≥1,500 njësi makinerish të reja të regjistruara.
• **Kooperim:** ≥30 SHBB të certifikuara sipas kriterëve të reja.
• **Sigurime bujqësore:** ≥500 kontrata aktive në skemat pilot.

BILANCI I SHKURTËR I 25 VITEVE TË KASH
Në 25 vite veprimtarie, KASH ka ndërtuar një rrjet të qëndrueshëm prej 37 shoqatash e Këshilla Rajonale të Agrobiznesit. Anëtarësia e të cilave e tejkalon nr prej 100 mijë, ka asistuar në themelimin e 104 SHBB-ve dhe katër GVV në rrang qarku.
Ka organizuar mbi 200 trajnime, 25 konferenca kombëtare. 5 kongrese të agrobiznesit dhe dhjetëra tryeza sektoriale, duke ndikuar në politikat që prekin mbi 150 mijë fermerë e agropërpunues në gjithë vendin.
Boton Gazetën “Agrobiznesi” prej 25 vitesh, dy herë në muaj, në print dhe online dhe e shpërndan përmes Postës Shqiptare në të gjithë territorin e vendit.
Kjo përvojë e konsoliduar është garancia që propozimet e KASH mbeten realiste, të zbatueshme dhe të përputhura me drejtimin europian të bujqësisë shqiptare.

Agim Rrapaj
Kryetar i KASH

INFORMACIONE

Salla urim për Vitin e Ri: Mbështetje dhe zhvillim për bujqësinë shqiptare

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla viteve është një moment reflektimi dhe shprese, duke



përcolli një mesazh urimi për qytetarët dhe fermerët shqiptarë me rastin e ndërrimit të viteve, duke vënë theksin te roli i fermerëve në zhvillimin e vendit dhe tek objektivat për vitin e ri.

Në mesazhin e tij, ministri Salla theksoi se ndërrimi i

shprehur mirënjohjen për punën, sakrificën dhe kontributin e përditshëm të fermerëve në ndërtimin e një bujqësie më të fortë dhe të një Shqipërie më të zhvilluar. Ai nënvizoi se fermerët shqiptarë janë shtylla e sigurisë ushqimore

dhe e ekonomisë rurale, duke mbajtur gjallë tokën, traditën dhe prodhimin vendas edhe në kohë të vështira.

Ministri Salla bëri të ditur se Viti i Ri nis me ambicie të reja për sektorin bujqësor, me shumë mbështetje për fermerët, më shumë investime, rritje të digjitalizimit dhe zgjerim të mundësive për produktet shqiptare në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

Në përmbyllje të mesazhit, ai uroi që viti i ri të shënojë një hap përpara drejt zhvillimit, bashkëpunimit dhe mirëqenies për çdo familje shqiptare, duke përcjellë urimet për shëndet, paqe dhe mbarësi.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e mbylli mesazhin e tij me urimin: Gëzuar Vitin e Ri!

Prezantohet metodologjia pilot e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës

Në kuadër të zbatimit të projektit EU for Property Rights, ekipi i projektit së bashku me përfaqësues të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, zhvilloi një prezantim mbi metodologjinë pilot të Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës dhe realizoi një vizitë në terren në fshatrat Roshnik dhe Kutalli në qarkun e Beratit.

Vizita ofroi mundësinë për të punuar drejtpërdrejt me inspektorët e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për të mbështetur zbatimin në terren dhe për të avancuar pilotimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës përmes angazhimit praktik.

Projekti EU for Property Rights financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNOPS në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadasrës dhe Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

European Union in Albania Agjencia për Zhvillim Bujqësor

dhe Rural United Nations Albania Kadastra Shqiptare



Autoriteti i Konkurrencës, analizë krahasuese të ecures së çmimeve për produktet e shportës

Autoriteti i Konkurrencës bën të ditur se është drejt përfundimit procesi i mbledhjes së të dhënave lidhur me çmimet e produkteve të shportës për periudhën tetor–

kryhet një analizë e detajuar krahasuese e ecures së çmimeve për secilin produkt, me synimin për të identifikuar çdo rritje të mundshme të pajustifikuar që

përqendrohet në krahasimin e çmimeve ndërmjet periudhave të ndryshme kohore, vlerësimin e strukturës së kostove dhe marzheve të fitimit, si dhe në evidentimin e çdo praktike që mund të cenojë konkurrencën e ndershme në treg.

Në rast se nga analiza statistikore dhe ekonomike do të konstatohen rritje të pajustifikuara të çmimeve apo praktika të ndaluara nga legjislacioni në fuqi, Autoriteti i Konkurrencës bën të ditur se do të ndërmarrë pa hezitim veprimet përkatëse ligjore, përfshirë hapjen e procedurave hetimore ndaj subjekteve përgjegjëse.

Autoriteti i Konkurrencës thekson se mbetet i angazhuar për garantimin e funksionimit të drejtë të tregut, mbrojtjen e konkurrencës dhe interesit të konsumatorëve, duke ushtruar me përgjegjësi të plotë kompetencat e tij ligjore.



nëntor–dhjetor, duke përfshirë të gjitha hallkat e zinxhirit të furnizimit dhe tregtimit.

Sipas njoftimit zyrtar, pas përmbylljes së kësaj faze, do të

mund të jetë pasojë e sjelljeve jo konkurruese apo e koordinimit të paligjshëm ndërmjet operatorëve ekonomikë.

AK sqaron se analiza do të

Sallaku: Mbi 1400 fermerë të trajnuar nga UBT, monitorim mbi 45 fermave model

Rекtori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatbardh Sallaku tha se bujqësia nuk është

sionon vetvetiu, asnjë fond nuk jep rezultat vetëm sepse ekziston. Politikat marrin vlerë



thjesht një sektor ekonomik, ajo është një shtyllë strategjike e zhvillimit të vendit.

Sallaku e bëri këtë deklaratë gjatë aktivitetit të zhvilluar në Elbasan, takim me fermerë dhe sipërmarrës të këtij sektori, ndërsa të pranishëm ishin edhe Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla.

Sallaku tha se “ajo që konfirmohet është fakti që mbështetja e Qeverisë për bujqësinë është rritur jo vetëm në shifra, por edhe në vizion, në skema mbështetëse më të strukturuar dhe një qasje më pranë fermerit dhe biznesit privat”.

“Asnjë politikë nuk funk-

vetëm kur kuptohen, zbatohen dhe përvetësohen nga njerëzit që punojnë në terren, kur shfaqërohen me dije, kapacitete njerëzore etj. Nëse duam një bujqësi konkurruese për në BE, krahas buxheteve dhe skemave mbështetëse, duhet të theksojmë edukimin, trajnimin dhe përgatitjen profesionale të fermerëve. Evropa nuk matet me fonde, por me standarde, dhe ato fillojnë nga dija dhe këtu edukimi dhe trajnimi bëhen themeli i çdo suksesi”, tha Sallaku.

Sipas Sallakut, trajnimi është ura që lidh ligjin me praktikën, buxhetin me rezultatin, ai e kthen ndihmën në investim

dhe i jep fermerit sigurinë për të marrë vendime më të mira dhe më afatgjata.

“Me këtë bindje, Universiteti Bujqësor i Tiranës për tre vite ka zhvilluar skemën e trajnimeve në bujqësi duke e parë këtë angazhim jo thjesht si detyrë institucionale, por si përgjegjësi kombëtare. Gjatë këtyre viteve kemi trajnuar mbi 1400 fermerë nga gjithë Shqipëria, mbi 300 specialistë nga Ministria e Bujqësisë, janë zhvilluar mbi 200 ditë trajnimi intensiv dhe janë monitoruar mbi 45 ferma model”, pohoi ai, ndërsa theksoi se këto ferma nuk janë vetëm histori suksesi, por shkolla praktike ku dija dhe teknologjia testohen dhe japin rezultate.

“Bujqësia shqiptare ndodhet në një moment vendimtar. Shqipëria ka hapur kapitujt e negociatave me BE-në dhe kjo do të thotë se nuk flasim vetëm për aspirata, por detyrime konkrete, për të ndryshuar modelin e bujqësisë, për ta bërë plotësisht evropiane. Fermerët duhet të ndërgjegjësohen që teknologjia dhe digjitalizimi nuk janë më kosto, por aleatë që i hapin dyert tregjeve ndërkombëtare”, tha Sallaku.

Tatimet zbulojnë 9,3 milionë euro të padeklaruar nga një kompani produkteve shtazore

Vijon aksioni për garantimin e sigurisë ushqimore dhe formalizimin e sektorit të tregtimit të produkteve blegtorale.

Administrata Tatimore ka identifikuar një subjekt të tatimpaguesve të mëdhenj, i cili ushtronte aktivitetin e tregtimit me shumicë të produkteve shtazore në kundërshtim me legjislacionin tatimor në fuqi, duke kryer evazion fiskal.

Nga verifikimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), është konstatuar një mospërputhje e ndjeshme mes inventarit fizik dhe atij të deklaruar, në sasinë prej 4041 tonë nënprodukte mishi.

Gjithashtu, nga kontrollet

e realizuara nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në DPT, u konkludua se subjekti kishte fshehur të ardhura në vlerën rreth 9,3 milionë euro.

Rasti i është referuar për hetim të mëtejshëm hetimit

tatimor, i cili e ka përcjellë çështjen për ndjekje penale pranë Prokurorisë së Tiranës, për veprën penale “evazion fiskal”, me një dëm të vlerësuar ndaj të ardhurave tatimore në shumën 6,4 milionë euro.



Shtohen kontrollet për sigurinë ushqimore gjatë festave

Në prag të festave të fundvitit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka intensifikuar kontrollet dhe këshillimet në terren për garantimin e sigurisë ushqimore, bën të ditur ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla.

Sipas ministrit, kjo nismë po zhvillohet në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere “Shijo Festat me Siguri”, e cila synon rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore në një periudhë kur konsumi i produkteve ushqimore shënon rritje të ndjeshme.

Qarku i Vlorës ishte ndalesa e radhës e grupeve të AKU-së, ku fokusi kryesor ishte orientimi dhe këshillimi i operatorëve të biznesit ushqimor mbi rëndësinë e etiketimit të saktë të produkteve ushqimore të paketuara.

Salla nënvizoi se etiketimi në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk është vetëm një detyrim ligjor për subjektet tregtare, por një element kyç për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe garantimin e transparencës ndaj tyre.

Ministri i Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural bën të ditur se kontrollet dhe aktivitetet informuese të AKU-së do të vijojnë edhe në qarqe të tjera të vendit gjatë gjithë periudhës së festave, në bashkëpunim me operatorët e biznesit ushqimor, me qëllim garantimin e produkteve të sigurta dhe cilësore për qytetarët.

Fushata synon gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për rëndësinë e leximit të etiketave ushqimore dhe zgjedhjen e produkteve që përbushin standardet e sigurisë.

TEKNOLOGJI

EuroAgro Albania 2025-2030, platformë e re për asistencën e fermerëve

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla prezantoi vizionin dhe hapat konkretë të transformimit të sektorit bujqësor dhe rural në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke theksuar se anëtarësimi i Shqipërisë në

“Anëtarësimi në Bashkimin European sjell përfitime për fermerët, bizneset, konsumatorët dhe ekonominë e vendit, por përfitimi nuk vjen automatikisht. Ai vjen vetëm kur të gjithë aktorët janë të përgatitur, me investim, dokumentim dhe

rëndësinë e përbushjes së standardeve të cilësisë dhe tregimit, duke paralajmëruar një paketë ligjore, proces komunikimi dhe trajnime për prodhuesit dhe operatorët e tregut. Sipas tij, organizimi i fermerëve në grupe prodhuesish mbetet elementi kyç për të kapërcyer ekonominë e shkallës dhe për të përthithur në mënyrë efektive fondet europiane.

Në Kapitullin 12, fokusi është siguria ushqimore dhe zbatimi real i legjislacionit të BE-së në të gjithë zinxhirin, ndërsa Kapitulli 13 kërkon digjitalizim, monitorim, raportim dhe kontroll, me forcim të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit elektronik me strukturat europiane.

Në këtë kuadër, ministri prezantoi platformën EuroAgro Albania 2025–2030, si një mekanizëm praktik për përgatitjen graduale të fermerëve dhe operatorëve drejt standardeve të Bashkimit European. Platforma parashikon një linjë të dedikuar asistencë “Numri Blu”, një platformë digjitale informative me asistent virtual në Portalin e Fermerit, si dhe pika informuese, materiale udhëzuese dhe trajnime në terren, në bashkëpunim me bashkitë, shërbimet e ekstensionit dhe shoqatat profesionale.

“Nëse bëhemi bashkë në këtë rrugëtim, ‘Bujqësia 2030’ do të kthehet në një standard pune dhe në një treg të ri mundësish për bujqësinë shqiptare” u shpreh Salla.

Bashkimin European është një proces që kërkon përgatitje, angazhim dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve të zinxhirit bujqësor.

Në takimin e organizuar me fermerë, Salla u ndal te çelja zyrtare e Grupit të Kapitullit 5 në Konferencën e 7-të Ndërqeveritare më 17 nëntor, ku përfshihen Kapitujt 11, 12 dhe 13, që mbulohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai theksoi se këta kapituj janë ndër më dinamikët dhe kërkojnë jo vetëm përafrim të legjislacionit dhe zbatim të standardeve, por edhe transformim të thellë dhe modernizim të sektorit.

cilësi në çdo hallkë të zinxhirit”, u shpreh ai.

Në lidhje me Kapitullin 11 dhe Politikën e Përbashkët Bujqësore, ministri theksoi se fermeri vendoset në qendër të politikave mbështetëse, me synimin për një bujqësi më konkurruese, më të qëndrueshme dhe me më shumë siguri ushqimore. Ai bëri me dije se objektivi është që rreth 150 mijë fermerë të përfitojnë nga fondet europiane, duke nënvizuar se në dy vitet e ardhshme do të përditësohet regjistri i fermës dhe i blegtorisë, si dhe do të ngrihet sistemi i identifikimit të parcelave të tokës.

Salla theksoi gjithashtu

Bashkia e Korçës do të ngrejë fermë model për kultivimin dhe ambalazhimin e mollëve

Një fermë model për kultivimin e mollëve, e pajisur me teknologjitë më të fundit, si dhe një qendër moderne për seleksionimin dhe paketimin e tyre, do të ngrihet në qytetin e Korçës si investim i bashkisë, me synim rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendas dhe zgjerimin e tregjeve për fermerët.

Kryetari i bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo, në një intervistë për mediet, theksoi se projekti pritet të nisë zbatimin e tij gjatë vitit të ardhshëm dhe vlerësohet si një ndër investimet më të rëndësishme në mbështetje të bujqësisë në këtë zonë.

Sipas Filos, molla është një nga produktet bujqësore me potencial të lartë për Korçën, ndaj ky projekt do të krijojë kushtet për trajtimin e saj sipas standardeve bashkëkohore.

“Ky projekt është shumë i rëndësishëm, sepse do të krijojë mundësinë për zhvillimin e tregut të mollës, e cila vlerësohet me potencial të madh për bujqësinë dhe fermerët e Korçës. Përmes seleksionimit dhe paketimit sipas standardeve, fermerëve do t’u

krijohet mundësia që produkti të ketë akses edhe në tregjet ndërkombëtare”, u shpreh kryebashkiaku.

Ai shtoi se ferma model do të shërbejë edhe si pikë referencë për fermerët e zonës, duke ofruar praktika të reja kultivimi dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore, ndërsa qendra e seleksionimit dhe paketimit do të garantojë cilësi të qëndrueshme dhe rritje të vlerës së produktit.

Projekti pritet t’i japë një hov të ri zhvillimit të sektorit bujqësor në Korçë, duke forcuar zinxhirin e prodhimit dhe tregtimit të mollës, si dhe duke kontribuar në rritjen e të ardhurave për fermerët e zonës.

Qarku i Korçës është zona kryesore e kultivimit të mollëve në Shqipëri, duke zënë një pjesë shumë të madhe të prodhimit kombëtar.



dhimit kombëtar. Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Korça kontribuon me rreth 63% të totalit të prodhimit të mollëve në vend në grupin e frutave me fara, ku molla përbën pjesën kryesore të këtij segmenti të frutave të pemës.

Kjo traditë e kultivimit të mollëve bazohet në kushtet e favorshme klimatike të zonës, duke e bërë Korçën një lider produktiv në sektorin e frutave në Shqipëri.

Në nivel kombëtar, qarku i Korçës është një nga zonat me sipërfaqe të konsiderueshme të mbjellë me mollë, deri në rreth 4000 hektarë, ku mjaft fermerë kultivojnë varietete të ndryshme të këtij fruti.

Varietetet më të kultivuara përfshijnë derivatet e Red Chief dhe Starking, si dhe Golden Delicious, varietete që zënë një pjesë të madhe të kësaj kulture në shkallë vendi.

Një pjesë e madhe e mollëve të Korçës përdoret për tregun vendas, por gjithnjë e më shumë pjesë e prodhimit shkon drejt tregjeve të huaja, duke rritur potencialin eksportues të sektorit.

Rama: “EuroAgro Albania”, kanal i hapur dialogu për fermerët dhe bizneset drejt anëtarësimit në BE

“EuroAgro Albania”, një platformë e prezantuar këtë javë për fermerët, është një mekanizëm praktik dhe i domosdoshëm për përgatitjen e bujqësisë dhe sektorit ushqimor për tregun e përbashkët evropian.

Kryeministri Edi Rama, gjatë podkastit “Flasim” solli në vëmendje këtë instrument, ndërsa u shpreh se kapitujt 11, 12 dhe 13, që lidhen me bujqësinë, janë në zemër të procesit të negociatave të anëtarësimit.

“Do të jetë një sfidë e fortë, por çka kemi bërë në një dekadë, na jep besim dhe forcë se do të bëjmë gjithçka duhet për t’ia dalë edhe në dy vitet e ardhshme që t’i mbyllim negociatat deri në fund të vitit 2027”, siguroi Rama.

Kryeministri kujtoi se një dekadë më parë, vetëm 5600 fermerë merrnin një mbështetje simbolike nga shteti.

Ndërsa sot, sipas tij, “janë 67.500 fermerë që përfitojnë

çdo vit mbështetje reale, e cila peshon në portofolin e fermës së tyre”.

“Eksportet dikur ishin një privilegj i një grushti fermerësh, ndërsa sot produktet shq-



iptare shkojnë në 80 vende të botës dhe eksportet kanë kaluar gjysmë miliard euro, ndërkohë që raporti i deficitit tregtar, pra eksporte dhe importe të produkteve ushqimore, ka zbritur nga 1 eksport, 9 import në 1 eksport dhe vetëm 3 import”, tha Rama.

Por, Kryeministri u shpreh se sot jemi në një tjetër nivel, por edhe sfidat janë të një niveli tjetër.

“EuroAgro Albania” nuk është një website më shumë,

nuk është një faqe më shumë në internet, por është një instrument pune, një udhërrëfyes hap pas hapi, si burim informacioni për standarde, afate dhe detyrime konkrete, si edhe një kanal dialogu i hapur për fermerët dhe bizneset në këtë rrugë drejt anëtarësimit”, tha Rama.

Fermerët duhet të nisin grumbullimin e faturave për kompensimin 10%. Kërkesa do bëhet dy herë në vit

Fermerët që shesin prodhimet e tyre bujqësore tek grumbulluesit, përpunuesit apo agroturizmet e certifikuar duhet të nisin grumbullimin e autofaturave, në mënyrë që të përfitojnë kompensimin 10% nga skema e re e TVSH-së.



Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar” i miratuar nga Parlamenti përcakton se kompensimi i TVSh-së 10% të fermerëve do të bëhet mbi vlerën e faturave të lëshuara nga blerësi i produkteve të tyre bujqësore. Për fermerët e pajisur me NIPT tatimor, pra që nuk janë subjektet të regjistruara në QKB, ligji parashikon se fatura e shitjes apo autofatura lëshohet prej blerësve të mallrave bujqësore.

Në total sipas të dhënave të Ministrisë së Financave nga viti 2018 deri në shtator 2025 janë të pajisur me NIPT tatimor 110 mijë fermerë.

Kjo autofaturë e lëshuar për fermerin nga përpunuesi, grumbulluesi, apo një agrotur-

izëm i certifikuar do të shërbejë si bazë për llogaritjen e kompensimit, i cili përfaqëson 10% të vlerës së saj dhe synon të mbulojë pjesërisht TVSH-në që fermerët kanë paguar për inputet bujqësore, si plehra kimike, fara dhe fidanë.

P.sh nëse një fermer i pajisur me NIPT do të shesë produkte bujqësore, me vlerë 1,000 euro, dhe për këtë shitje grumbulluesi apo përpunuesi do të lëshojë autofaturën përkatëse, atëherë fermeri do të përfitojë një kompensim prej 10%, pra 100 euro.

Kërkesa për kompensim do të bëhet dy herë në vit, për periudhat janar–qershor dhe korrik–dhjetor.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Andis Salla gjatë një takimi në Elbasan me fermerët bëri thirrje për grumbullimin e autofaturave me qëllim përfitimin e kompensimit.

“Fermerët që shesin prodhimet e tyre bujqësore tek grumbulluesit, përpunuesit ose agroturizëm do të kompensohen në masën 10% të vlerës së

faturës. Kjo faturë do të lëshohet nga blerësi i produkteve të tyre.

Ju i grumbulloni këto fatura, i dorëzoni në tatime çdo 6 muaj dhe shteti ju kthen 10% të vlerës së faturave direkt në llogarinë tuaj bankare”, u shpreh ministri Salla.

Po ashtu më herët nga tatimet u sqarua se parashikohet që fermerët vitin e ardhshëm të dorëzojnë kërkesën përmes platformës e-Albania dhe të konfirmojnë online çdo autofaturë të lëshuar në emrin e tyre. Pas verifikimit, shumata e kompensimit do të derdhet direkt në llogarinë bankare të fermerit brenda 30 ditëve.

Përfitues të skemës janë fermerët që nuk janë subjekt i TVSH-së dhe që nuk ngarkojnë TVSH në shitjen e produkteve të tyre, por që njëkohësisht nuk kanë të drejtë të rimburojnë TVSH-në e paguar për blerjet.

Skema synon kompensimi 10% i TVSh-së së paguar për inputet bujqësore, por që nuk do të llogaritet direkt mbi blerjet e fermerit për plehra kimike, fidanë apo fara, por mbi vlerën e autofaturave të lëshuara nga grumbulluesi për produktet bujqësore që fermeri do të shesë te ta. Sipas ligjit të TVSH-së fermerët e pajisur me NIPT nuk lëshojnë fatura shitje nëse shesin produktet e tyre bujqësore te persona të tatueshëm, por janë këta të fundit që lëshojnë autofaturën për fermerin.

“Monitor”

AKTUALITET

Zv.ministri Guri: Vijon evidentimi i dëmeve nga përmbytjet

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Guri deklaroi se ka nisur evidentimi i dëmeve në zonat e përmbytura në vend.

Në një intervistë në medie, Guri u shpreh se ekspertët ndodhen në terren, teksa shtoi se ndër zonat më të prekura, janë Shkodra, Lezha, Kurbini, Durrësi, Berati, Vlora dhe Fieri.

“Evidentimi ka nisur që në ditët e para kur u shfaqën këto problematika. Ekspertët që ka në terren Ministria e Bujqësisë, kanë qenë në dispozicion të bashkive dhe autoriteteve lokale, për të kryer së bashku procesin e evidentimit të problematikave dhe dëmeve, si pasojë e reshjeve që ranë ditët e fundit në vendin tonë”, theksoi ai.

Sipas zv.ministrit, pati një situatë anormale nga reshjet.

“Niveli i shirave që ranë për një kohë të shkurtër ishte e barabartë me nivelin disamujor të reshjeve që në vite normale bien në këto zona. Edhe funksioni i sistemit të kullimit, që ka qenë në funksionim në këto zona, nuk ka kryer plotësisht eliminimin e efekteve që vijnë nga kjo situatë anormale atmosferike”, tha Guri.

Guri nënvizoi se gjysma e buxhetit që ministria ka në dispozicion, i dedikohet pjesës së

kullimit.

“Ruajtja e kanaleve kryesore dhe argjinaturave, është

ashtu siç kemi bërë edhe më parë. Më tej, elementët që janë identifikuar si sfidues do të



detyrë që ministria e mbështet me fonde të konsiderueshme. Gjysmën e buxhetit që kemi në dispozicion ia dedikojmë për pjesën e ujit dhe të kullimit. Pjesa e ruajtjes e sistemit të kullimit është detyrim i vazhdueshëm. Edhe pastrimi i kanaleve kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Punonjësit tanë janë në terren”, u shpreh zv.ministri i Bujqësisë.

Ndër të tjera, Guri tha se në vitin 2026 është planifikuar vijimi i investimeve.

“Ne do të vazhdojmë të konsiderojmë prioritarë investimet në ujitje dhe kullim,

jenë prioritarë për mbështetje me investime gjatë vitit 2026,” u shpreh Guri.

Por sipas tij, investimet bëhen në bazë të kapaciteteve të reshjeve. “Në kushtet kur këto kapacitete tejkalohen disa herë gjatë një periudhe 3-ditore, kur kemi regjistruar 50% të reshjeve të të gjithë janarit, atëherë situata nuk lidhet vetëm me sistemin e kullimit, por edhe me reshjet anormale”, tha ai.

Guri informoi se kur evidentimi dhe analizimi i dëmeve të përfundojë, do të përcaktohet dhe vlera e dëmeve

10 fabrika të përpunimit të ullirit në Finiq, asnjë prodhues nuk e ka të certifikuar vajin

Fermerët në Bashkinë e Finiqit vjelin prodhimin e rreth 100 mijë rrënjëve ulliri. Përpunimi i prodhimit të ullinjve bëhet në fabrikat e vajit, të cilat janë shtuar gjatë viteve të fundit.

Megjithatë, shitja e vajit të ullirit vazhdon të kryhet me mënyra tradicionale, pasi asnjë fermer nuk ka arritur të sigurojë certifikimin e tij.

“Çdo gjë duhet të vihet mbi bazë ligjore, të certifikohet të shtohet cilësia e fabrikave të

vajit, nga ana teknologjike e higjienike, me qëllim që cilësia e vajit dhe gjithçka tjetër të jetë e bazuar në ligj si në të gjithë botën”, deklaroi specialisti i bujqësisë, Stefanos Moraitis.

Ndonëse shitja e prodhimit të vajit ka vijuar normalisht, fermerët vazhdojnë të kërkojnë ndërtimin e Qendrës së Grumbullimit të Prodhimeve Bujqësore dhe Blegtorale.

“Është gjëja më e nevojshme që ky vend të popullohet, të zhvillohet. Është gjëja më e do-

mosdoshme edhe e produkteve bujqësore dhe e produkteve blegtorale, të kenë mundësi të rrisin prodhimin e tyre dhe të jetojnë apo dhe ajo pjesë e popullatës që i ka për përdorim vetjak të marrin dhe ata një zhvillim të dukshëm”, shtoi specialisti.

Banorët e Finiqit e përdorin vajin e ullirit për nevojat familjare, apo të fëmijëve emigrantë. Por ka edhe disa fermerë të cilët e shesin vajin në tregun e brendshëm.

Ngricat dëmtojnë agrumet dhe perimet në serra - Fermerët në Lushnjë: U dëmtuan edhe fidanët e rinj

Ditët e para të janarit kanë sjellë ngrica në territorin e bashkisë Lushnjë. Si pasojë e tyre, janë dëmtuar agrumet dhe perimet në serra. Limonët, mandarinat dhe portokallet kane ngrirë në pemë, ndërsa një pjesë tjetër ka rënë në tokë. Prodhimi ende nuk ishte vjelë pasi fermerët i kishin lënë për ti shitur në fund të janarit.

Fermerët e fshatit Shegas, thonë se kishin dijeni për ditët me temperatura -6 të datave 1,2

dhe 3 janar, ndaj morën masa. Ata dyfishuan mbrojtjen me plastmasë, ndezën disa bombola gazi, madje edhe zjarre brenda serrave, por bimët nuk i shpëtuan nga ngrirja. Dëmi për një dynym serrë me domate sipas prodhuesve, llogaritet në 15 milion lekë të vjetra.

“I ftohti na ka bërë shumë dëme sidomos në perime, në kulturën e domates dhe kastravecit”, u shpreh një fermer.

“Dëme kemi në më shumë se 50% të serrave”, u shpreh

një tjetër fermer.

Fermerët që kishin serrat me domate dhe specat gati për shitje, i kishin lënë për ti vjelë pas datës 10 janar, por ngrica ia prishi prodhimin. Po kështu, temperaturat e ulëta dëmtuan tërësisht edhe fidanët e rinj të sapo mbjellë në serra. Fermerët thonë se pasojat do të jenë afatgjata, pasi deri në muajin mars-prill ata e kanë të vështirë të përgatisin tokën për mbjelljet e reja.

Hapet tregu i ri në Elbasan, ministri Salla: Kushte moderne për tregtarët dhe siguri për konsumatorin

Tregtimi i fruta-perimeve në Rajonin nr. 1 në Elbasan ka marrë një dimension të ri, falë investimit më të fundit që ka transformuar kushtet e punës dhe shërbimit.

Lajmi u bë i ditur nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, i cili përmes një postimi në rrjetet sociale njoftoi hapjen e tregut të ri. Sipas ministrit, ky investim nuk përmirëson vetëm estetikën urbane, por mbi të gjitha garanton sigurinë ushqimore.

Struktura e re është projektuar për t’u shërbyer rreth 35 tregtarëve, të cilët largohen nga kushtet e vështira për t’u vendosur në ambiente bashkëkohore.

“Hapësira është e mbyllur plotësisht me struktura xhami,

e pajisur me ndriçim efikas dhe me kushte optimale për ruajtjen

konkret drejt formalizimit të tregut të produkteve bujqë-



dhe tregtimin e produkteve ushqimore”, shkruan Ministri Salla.

Ky projekt shihet si një hap

sore, duke ofruar dinjitet për tregtarët dhe garanci higjienosanitare për qytetarët që furnizohen aty çdo ditë.

Shqipëria, drejt bujqësisë moderne - Hapet rruga ligjore për akuaponinë, aeroponinë dhe hidroponinë

Sektori bujqësor në Shqipëri po hyn në një fazë të re transformimi, si pasojë e nevojës për rritjen e produktivitetit, eficiencës dhe përfundimit me modelet bashkëkohore të vendeve me bujqësi të zhvilluar. Kërkesa në rritje për produkte bujqësore cilësore, presioni mbi tokën bujqësore, sfidat klimatike dhe mungesa e fuqisë punëtore, mesa duket kanë shtuar domosdoshmërinë për adoptimin e teknologjive inovative në këtë sektor.

Kështu, teknologji si akuaponia, aeroponia dhe hidroponia po konsiderohen si alternativa moderne që mund të rrisin ndjeshëm prodhimin bujqësor, duke reduktuar përdorimin e ujit, hapësirës dhe inputeve tradicionale. Megjithatë, deri më tani, legjislacioni shqiptar nuk e ka pasur të parashikuar qartë ushtrimin e aktivitetit bujqësor përmes këtyre teknologjive në tokë bujqësore, duke krijuar paqartësi ligjore për investitorët dhe fermerët.

Për të adresuar këtë bosh-

llëk, qeveria synon që brenda muajit Prill 2026 të iniciojë disa ndryshime ligjore të cilat e cila synojnë plotësimin e kuadrit ekzistues dhe rregullimin e ushtrimit të aktivitetit bujqësor përmes teknologjive inovative.

Qëllimi i projektligjit është të mundësojë zyrtarisht zhvillimin e akuaponisë, aeroponisë dhe hidroponisë në tokë bujqësore, duke garantuar njëkohësisht ruajtjen e funksionit bujqësor të tokës dhe përputhjen me standardet mjedisore. Konkretisht akuaponia është një metodë që kombinon rritjen e peshqve në rezervuare, ndërsa hidroponia dhe aeroponia përdoren për rritjen kultivimin e bimëve pa pasur nevojë për tokë.

Aplikimi i këtyre teknologjive synon ndër të tjera rritjen e investimeve në bujqësi, modernizimin e fermave ekzistuese, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet rajonale dhe europiane.

Por a është e nevojshme në

rastin e Shqipërisë e cila ka hapsira të mëdha të tokave bujqësore që aktualisht nuk janë në përdorim?

Prof. Dr. Evan Rroço, Pedagog, Departamenti i Agronomisë, UBT: “Kjo është më tepër për vendet që kanë më pak tokë dhe klimë të tillë që nuk e lejojnë kultivimin normal të bimëve. Unë do ta shikoja më tepër për vendet që akoma nuk kanë kushtet normale për ti prodhuar këto produkte në fushë të hapur. Sigurisht në një moment që nuk do të kemi fermerë dhe klima do të ndryshojë në mënyrë të tillë që nuk do ketë më reshje dhe që nuk do marrim masa për rregullimin e sistemit ujitës që nuk funksionon, atëherë mund të jetë një opsion”.

Megjithatë, nëse zbatohet në mënyrë efektive, reforma ligjore mund ta pozicionojë Shqipërinë si një vend konkurrues në fushën e bujqësisë inovative në rajon, duke shfrytëzuar potencialin e teknologjisë për zhvillim ekonomik afatgjatë.

AZHBR: Nuk janë kryer pagesa për kontrata të kontestuar

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) bëri të ditur se nuk ka kryer asnjë pagesë ndaj individëve të dyshuar për veprimtari kriminale.

Reagimi i AZHBR-së i referohet lajmit të publikuar në medie se në shkurt 2025, Xhevdet Troplini, përfitoi një grant bujqësor prej 22 milionë

lekësh nga AZHBR për fermën e tij në Xhafzotaj.

Sipas njoftimit zyrtar të AZHBR, çdo kontratë dhe grant i administruar nga agjencia bëhet në përputhje të plotë me kriteret dhe procedurat e parashikuara në udhëzimin e shtatorit të vitit 2024, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të

programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

AZHBR informoi se subjekti në fjalë është kontraktuar në përputhje të plotë me kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë akt për programet e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

INFORMACIONE

Nga ngricat te përmbytjet, bujqësia përballet me dëme të rënda në disa qarqe

Ngricat në ditët e para të vitit të ri dhe tani përmbytjet e ditëve të fundit kanë shkatërruar një pjesë të madhe të prodhimit dhe fidanëve të sapombjellë në zonat me bujqësi intensive.

Emergjencat civile raportuan dje se mijëra hektarë tokë në Lezhë, Shkodër, Berat, Lushnjë dhe Durrës janë përmbytur, ku, veç të tjerash, kanë krijuar një dëm të madh në bujqësi. Mariglen Ziu, një fermer në zonën e Beratit, pohoi se një pjesë e madhe e serrave u dëmtuan rëndë nga ngricat e ditëve të para të vitit dhe ato që shpëtuuan janë zhytur poshtë ujit.

Ervin Resuli, një ekspert i çështjeve të bujqësisë, tha se i gjithë vendi po përballet me humbje këto ditë. Dëmet kanë përfshirë edhe ushqimin e gjësë së gjallë.

Këto ditë të vështira nuk janë humbje vetëm për fermerët, por për të gjithë ekonominë tonë. Një pjesë e serrave ishin në kulmin e prodhimit të sezonit të dytë dhe disa të tjera sapo kishin mbjellë fidanët për sezonin e hershëm të pranverës 2026.

Dëmtimi i prodhimit do të sjellë kufizim të furnizimit në tregje. Përvoja ka treguar se në këto raste, çmimet rriten. Përmbytjet në bujqësi nga humbje individuale kthehen në çekuilibru të ekonomisë kombëtare, me rënie të prodhimit dhe rritje të inflacionit.

Dëmet e krijuara do të mbarten për një kohë të gjatë, pasi në shumë serra, bashkë me prodhimin, janë dëmtuar skellet dhe plasmasët. Gjithashtu, hyrja e llumit në sera do të vështirësojë rifillimin e punës

dhe mbjelljeve gjatë periudhës në vijim.

Fermerët shqiptarë nuk kanë kapacitete për të përbaluar fatkeqësitë natyrore, të cilat janë shtuar vitet e fundit, ndërsa qeveria shqiptare ofron mbështetje shumë të ulët në raport me rajonin dhe BE-në.

Gjithashtu, feramat tona nuk i aplikojnë skemat e sigurimit privat, teksa nuk funksionon as mekanizmi i kompensimit nga fatkeqësitë natyrore.

Emergjencat civile pohuan se rreth 3000 ha tokë bujqësore janë nën ujë në Lezhë. Në Berat, rreth 95 ha tokë bujqësore ishte nën ujë dhe rreth 200 ha tokë bujqësore e përmbytur ishte në Fier. Në zonën e Shkodrës, uji ka mbuluar edhe rrugën nacionale dhe tokat me histori përmbytjeje.

“Monitor”

Taksa e mbetjeve do ndryshojë, për familjet dhe bizneset do ndiqet parimi “Paguaj sipas hedhjes”

Familjet dhe bizneset do të paguajnë një taksë “individuale” sa i takon mbetjeve që gjerorjnë e cila do të ndjekë parimin “Paguaj sipas hedhjes”.

Në Programin Kombëtar të Parandalimit të Krijimit të Mbetjeve nxjerre per konsultim, qeveria parashikon këtë si një ndër masat që do të zbatohen në vazhdim. Konkretisht do të synohet që të shkohet drejt një sistemi të ri që inkurajon riciklimin. “Paguaj sipas hedhjes” (PAYT) është parimi që ofron nxitje ekonomike në reduktimin e mbetjeve, duke inkurajuar qytetarët të riciklojnë më shumë dhe të reduktojnë krijimin e tyre. Sistemi PAYT, konsiderohet një nga instrumentet ekonomikë më efektivë për reduktimin e mbetjeve dhe promovimin e konsumit të përgjegjshëm. Zbatimi i tij mundëson vendosjen e tarifave të balancuara të mbetjeve bashkiake, sipas të cilit çdo familje ose biznes, pagan sipas sasisë aktuale të mbetjeve të gjeneruara, në vend të një tarife fikse. Në këtë mënyrë, familjet dhe bizneset do të nxitin të ndajin sa më shumë mbetje të riciklueshme të jetë e mundur (për

të cilat nuk do të paguajnë) dhe do të paguajnë një tarifë mbetjesh vetëm për mbetjet e mbetura të përziera” thuhet në masën 6 të këtij programi.



Sipas qeverisë zbatimi i PAYT kërkon ndryshime thelbësore si në mënyrën e ndarjes së tarifave të mbetjeve bashkiake midis familjeve dhe bizneseve ashtu dhe në sistemin e grumbullimit të mbetjeve bashkiake. Kështu modeli i grumbullimit në pika të përbashkëta duhet të zëvendësohet gradualisht me përdorimin e koshave/kontejnerëve individualë duke mundësuar matjen e sasisë së mbetjeve për familje dhe subjekte biznesi.

Plani që ky sistem i ri të vihet në jetë është brenda vitit 2029 duke i vënë bashkitë para detyrimit të plotësimit të kuadrit dhe logjistikës që

kërkon kjo praktikë e re. “Paralelisht me zhvillimin e modeleve për grumbullimin e mbetjeve, MM do të iniciojë ndryshimet e nevojshme ligjore për adoptimin e sistemit PAYT duke mundësuar zbatimin e tarifave të bazuara në peshë dhe/ose vëllim për shërbimet bashkiake të menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë do të fillojnë të aplikojnë tarifimin PAYT për familjet dhe subjektet e biznesit, jo më vonë se viti 2029” thuhet në dokument.

“Monitor”

Shfryhet 20% stoku i sherbelës, Gjoka: Pas rënies së çmimit, fermerët braktisën kultivimet

Ashtu siç eksportuesit e sektorit të bimëve mjekësore parashikuan, sivjet ka nisur shfryrja e stokut të lartë të krijuar me mosshitjen e bimës së sherbelës.



Për kryetarin e Shoqatës së Eksporteve të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike Filip Gjoka stoku i lartë i sherbelës erdhi nga mbiprodhimi, pasi fermerët kultivuan pa planifikim dhe në mungesë së studimeve të kërkesës së tregut.

Për rrjedhojë mbiprodhimi nuk lejoi rritjen e çmimit të grumbullimit, ndërsa mosndryshimi i kërkesës jashtë ndikoi në mbajtjen e çmimeve të ulëta të shitjes për eksport.

Zoti Gjoka thotë se për 2025 stoku i sherbelës së pashitur ka rënë rreth 20% krahasuar me vjet e ndikuar nga pakësimi i prodhimit.

“Stoku i bimëve mjekësore

në tërësi është ulur, sidomos për sherbelën që krahasuar me vitin e kaluar ka rënë 20%. Faktorë që kanë ndikuar në uljen e stokut është rënia e prodhimit jo vetëm nga braktisja e fermerëve për prodhimin ku pas tkurrjes së çmimit filluan të mos shfaqin interes për kultivim, por edhe se një pjesë e tij u dëmtua nga temperaturat e larta.

Sivjet çmimi i sherbelës për grumbullim në eksport është

rritur nga 80 lekë për kg që u shit vjet, në 120 lekë për kg rreth 50% nga mungesa e prodhimit”.

Edhe Kujtim Zere drejtuesi i kompanisë “Albanian Herb” më herët parashikoi se që stoku i sherebelës do të nisë të shfryhet nga 2025, pasi rënia e çmimit të bimës në grumbullim për eksport zbehu interesin e fermerit për kultivim.

“Bima e sherbelës nuk po kultivohet në sasi të lartë. Çmimi do të vijojë të mbetet i lirë, derisa oferta në treg të pakësohet. Stoku i sherbelës ka qenë i lartë dhe ky është një tjetër faktor ndikues te pakësimi i çmimit. Parashikojmë që nga viti 2025 të nisë shfryrja e stokut, pasi ka nisur edhe rënia e kultivimeve”, pohoi ai më herët.

Vjet stoku i pashitur i sherbelës u rrit 1.5 herë brenda 6 muajve për shkak të mungesës së shitjeve nga rënia e çmimeve. Rënia e kërkesës për 2024 solli edhe përgjysmim të çmimit të shitjes. Nga 160 lekë për kg, për eksport sherbela u kërku me çmim 80 lekë për kg.

“Monitor”

Fermeri me aftësi të kufizuara, histori suksesi në bujqësi

Gëzim Loci, 46 vjeç, fermer nga Mirdita që jeton dhe punon në Lezhë, përfaqëson një shembull frymëzues të këmbënguljes, punës dhe dashurisë për bujqësinë.

Pavarësisht se prej rreth 25 vitesh jeton me aftësi të kufizuara, i verbër, ai është i angazhuar prej kohësh në zhvillimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, ndau historinë e tij si një model pozitiv i përfshirjes dhe punës në sektorin bujqësor.

Rrugëtimi i tij ka nisur në ferma të ndryshme, kryesisht në mbarëshkrimin e viçave dhe gjedhit, ku ka ndërtuar hap pas hapi përvojën profesionale dhe besimin në punën e ndershme. Në vitet e para, Gëzimi e ka nisur aktivitetin me kredi të vogla, duke hapur fermën pranë banesës

së tij, fillimisht duke kultivuar shalqi në 2 dynmë tokë, ndërsa ndërtoi edhe një stallë prej rreth 100 metrash katrorë.

Gëzimi tregon se gjithashtu

tivitetit, duke arritur të rrisë kapacitetet e fermës dhe të punësojë 4–5 punëtorë.

“Edhe pse puna në bujqësi është e vështirë, veçanërisht për



ai ka ngritur edhe një parcelë në fshatin Gurzë, ku kultivon 170 pemë frutore.

Të ardhurat e siguruar nga puna i ka riinvestuar vazhdimisht për zgjerimin e ak-

personat me aftësi të kufizuara, Gëzim Loci ka treguar se me vullnet, përkushtim dhe këmbëngulje, sfidat mund të kapërcehen dhe puna e ndershme sjell rezultate konkrete”, u shpreh Salla.

Informaliteti i lartë në sektorin e verës ka bërë që qeveria të marrë masa me qëllim krijimin e një database të plotë me të dhëna të detajuara.

Qeveria ka hartuar rregulloren e re, për të gjithë operatorët: vjelësit dhe prodhuesit e regjistruar në regjistrin e vreshtave, përpunuesit dhe mbushësit e shisheve, për mbajtjen e deklarave, formularët që duhet të plotësohen prej tyre, si dhe mënyrën e grumbullimit të informacionit për

Prodhuesit e verës, deklarime deri më 15 Janar - Rregullorja e re/ Detyrim për sipërfaqet e kultivuara dhe sasinë e produkteve

prodhimin potencial.

Referuar rregullores së re të botuar në Fletoren Zyrtare, e detyrueshme të zbatohet për të gjithë operatorët që janë regjistruar në regjistrin e vreshtave, prodhuesit duhet të dorëzojnë deklaratën e prodhimit në lidhje me prodhimin e vitit aktual

të verës brenda datës 15 janar të çdo viti. Deklarata duhet të përmbajë identitetin e prodhuesit; vendin ku mbahen produktet; kategorinë e produkteve të përdorura për prodhimin e verës: rrush, musht rrushi ose verë e re ende në fermentim, emrin dhe adresën e furni-

zueseve; vëllimin, e shënuar në hektolitra ose 100 kg, të produkteve të verës të marra që nga fillimi i vitit të verës dhe të mbajtura në datën e deklarimit, të ndara sipas ngjyrës (e kuqe/rozë ose e bardhë), kategorisë së produkteve të përdorura.

Formulari i deklaratës së

prodhimit, do t’u dorëzohet Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor të qarkut përkatës, ku ndodhet sipërmarrja. Deklarata duhet të dorëzohet edhe nëse prodhimi në vitin përkatës të verës ka qenë i barabartë me zero.


Po ashtu, prodhuesit, për-

punuesit dhe mbushësit e shisheve, të regjistruar në regjistrin e vreshtave, duhet të dorëzojnë deklaratën e stoqeve, brenda datës 10 shtator të çdo viti.

Kjo deklaratë duhet të përmbajë identitetin dhe vendin ku mbahen produktet.

Vjelësit duhet të dorëzojnë deklaratën e vjeljes deri më datë 15 janar të çdo viti e cila duhet të përmbajë identitetin e vjelësit; sipërfaqen e mbjellë

(Vijon në faqen 10)



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



AGROTURIZËM

Ibrahimaj: Ekonomia shqiptare rritet me 3.75%. Turizmi, motori kryesor i rritjes ekonomike në vitin 2025

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, ndau me publikun treguesit më të fundit të zhvillimeve ekonomike të vitit 2025, si edhe pritshmëritë për vitin 2026, duke vënë theksin tek nxitja e



inovacionit dhe përafrimi me standardet europiane.

Gjatë konferencës për mediat, ajo vlerësoi se ekonomia shqiptare ka vijuar rritjen e qëndrueshme, duke reflektuar performancë pozitive në shumicën e sektorëve kryesorë dhe një interes të shtuar të investitorëve vendas e të huaj.

Ajo u ndal fillimisht tek të dhënat e INSTAT për Prodhimin e Brendshëm Bruto, ku tha se „Sikurse jeni bërë me dije, INSTAT ka publikuar të dhënat e fundit për Prodhimin e Brendshëm Bruto, i cili në tremujorin e tretë të vitit rezultoi në nivelin 3.75% mbi tremujorin e tretë të vitit 2024. Kjo rritje është brenda pritshmërive të qeverisë dhe është ndjeshëm më e lartë se mesatarja e BE-së, e cila ishte 1.6%, dhe më e lartë se mesatarja për vendet e rajonit, ku rritja ishte 3.4%.“

Duke folur për sektorët që kanë kontribuar në këtë rritje, ministrja theksoi se administrata publike dhe taksat neto mbi produktet kanë sjellë efektin më të madh, ndërsa pasuritë e paluajtshme, ndërtimi dhe tregtia kanë dhënë gjithashtu kontribut të ndjeshëm.

Në nivel nëntëmujor, rritja ekonomike arriti 3,73%, ndërsa pritshmëritë janë që deri në fund të vitit 2025 të përmbushet objektivi prej 3,9%. Ministrja theksoi se administrata publike dhe taksat neto mbi produktet kanë sjellë rritjen më të madhe të ekonomisë, ndërsa sektorët e tjerë që kanë mbështetur rritjen janë pasuritë e paluajt-

shme, tregtia, akomodimi dhe ndërtimi. Nga ana tjetër, bujqësia dhe industria vijnë të jenë në terren negativ.

Ajo shtoi se “Analiza sipas sektorëve tregon se ekonomia është mbështetur kryesisht

restorantet shënuan rritje prej 16% në terma nominalë dhe 3,43% në terma realë. Në nivel nëntëmujor, shërbimet sollën në ekonomi 6,5 miliardë euro, me rritje 14%, ndërsa shërbimet e udhëtimit gjeneruan 4,4 miliardë euro të ardhura”.

“Konsumi i familjeve u rrit me 1,25%, duke reflektuar stabilitet dhe inflacion të kontrolluar, nën objektivin e Bankës së Shqipërisë. Importet neto dhe eksportet neto janë rritur respektivisht eksportet me 12,55%, ndërsa importet me 5,47%. Kjo ka sjellë një sufiçit prej 658 milionë euro në tremujorin e tretë dhe rreth 50 milionë euro në nivel nëntëmujor – një rezultat pozitiv që ndodh për herë të parë.”

Megjithatë, sa i takon tregtisë së mallrave, deficieti është ndikuar nga rritja e importeve të energjisë dhe rënia e eksporteve të metaleve bazë. Ministrja nënvizoi se eksportet e shërbimeve kanë dhënë kontributin kryesor në pozicionin e jashtëm të ekonomisë shqiptare.

“Investimet shënuan rritje prej 4,78% në tremujorin e tretë, duke treguar besim të qëndrueshëm në ekonominë shqiptare. Investimet e huaja direkte për nëntëmujorin e vitit 2025 arritën në 1,2 miliardë euro, me rritje prej 51 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Sektorët kryesorë përfitues janë pasuritë e paluajtshme me 31%, ndërmjetësimi financiar me 16%, hidrokarburet, energjetika dhe komunikacioni.”

Në tregun e punës, papunësia zbriti në 8,1%, ndërsa paga bruto mesatare arriti në 83,300 lekë, me rritje 7,25% krahasuar me vitin 2024.

Sa i takon tregut të punës, Ibrahimaj bëri të ditur se “Të dhënat flasin për një ekonomi të qëndrueshme, me tregues makroekonomikë të fortë dhe perspektivë pozitive edhe për vitin 2026. Raporti i fundit i Fondit Monetar Ndërkombëtar nënvizon një rritje ekonomike të qëndrueshme të ekonomisë shqiptare dhe tregues makroekonomikë të fortë. Si risk kryesor për ekonominë jo vetëm shqiptare, por të rajonit, theksohet paqëndrueshmëria e situatës globale dhe risqet që mund të vijnë nga kërkesa e huaj, të cilat për tremujorin e tretë të vitit nuk janë materializuar.”

Si turistët po shtojnë konsumin e pijeve alkoolike në vend, rriten prodhimi dhe importet



Gjatë periudhës janar–nëntor 2025 është rritur si prodhimi ashtu edhe importi i pijeve alkoolike. Megjithatë, sipas prodhuesve vendas të pijeve alkoolike dhe drejtuesve të bareve në Tiranë, peshën kryesore të konsumit e mban turizmi.

Sipas të dhënave të Doganave, për muajt janar–nëntor 2025 nga kompanitë vendase është prodhuar një sasi prej 315,8 mijë litrash pije alkoolike. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, prodhimi është rritur me 27%. Ndërkohë, në raport me periudhën para pandemisë së Covid-19, prodhimi është 48,4% më i ulët.

Sipas drejtuesve të bareve në Tiranë, pas pandemisë së Covid-19 mënyra e argëtimit dhe zakonet e konsumit të pijeve alkoolike në jetën e natës kanë pësuar ndryshime të ndjeshme.

Redi, themelues dhe banakier i “Radio Bar Tirana” në zonën e ish-Bllokut, thotë se aktualisht kërkesa për pije alkoolike, si për grupmoshën 20–30 vjeç ashtu edhe për moshat

mbi 40 vjeç, ka rënë me 30–40% krahasuar me periudhën para pandemisë së Covid-19.

“Nëse nuk do të kishte turizëm, industria jonë do të falimentonte. Me të rinj që nuk konsumojnë alkool si brezat e mëparshëm, me rënie të fuqisë blerëse për shkak të vështirësive ekonomike dhe me emigrimin e të rinjve, vetëm kërkesa e vendasve nuk do të mjaftonte për të mbajtur baret dhe klubet në Tiranë.

Kjo vërehet edhe në ndryshimin e frekuentimit. Nëse më parë periudha tetor–mars ishte periudha e “boom”-it për klubet e natës, tashmë nga nëntori deri në mars ato mbahen kryesisht nga frekuentimi i turistëve,” shprehet ai.

Se turistët mbajnë peshën kryesore të konsumit të pijeve alkoolike, e pohojnë edhe prodhuesit vendas.

Denis Zhilla, drejtor i përgjithshëm i kantinës së pijeve alkoolike “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, thotë se rreth 50% e konsumit total mbështetet nga turistët. Sipas tij, pijet më të preferuara janë konjaku dhe rakia prodhim

tradicional vendas, ndërsa vera, kryesisht e bardhë, preferohet më shumë nga moshat e reja.

Rritja e akcizës për pijet alkoolike nga 1 janari 2023 vijon të japë efekte negative të prodhimi vendas. Prodhuesit vendas pohojnë se detyrimi për akcizën zë 40% të vlerës për një shishe alkool 700 ml të prodhuar.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në ligjin “Për akcizat” nga 1 janari 2023 u unifikua edhe akciza e pijeve të forta alkoolike me nivel tarife 84,500 lekë për HL alkool. Para ndryshimeve për prodhuesit vendas dhe të huaj deri në 20,000 hl/vit akciza ishte 65,000 lekë për HL. Për fashën prodhuese mbi 20,000 hl/vit akciza ishte 84,500 lekë për HL.

Prodhuesit vendas në janar 2023 për shkak të ndryshimit të akcizës shtrenjtuan çmimeve e pijeve alkoolike deri 20%. Shtrenjtimi i çmimeve solli rënie konsumi, duke detyruar prodhuesit të pakësojnë prodhimin.

Ndërsa importi i pijeve alkoolike, si Wisky, Xhin, Vodka, Uzo, Tekila, Konjak për periudhën janar–nëntor 2025 sipas të dhënave të Doganave është rritur 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Në raport me periudhën para pandemisë së Covid 19 importet e pijeve alkoolike janë rritur rreth 87%.

Përfaqësuesit e kompanive importuese pohuan se zgjerimi i kërkesës ndikohet nga turizmi, pasi pijet alkoolike konsumohen më tepër në bare dhe restorante.

“Monitor”

Prodhuesit e verës, deklarime deri më 15 Janar - Rregullorja e re/ Detyrim për sipërfaqet e kultivuara dhe sasinë e produkteve



(Vijon nga faqja 7)

me vreshta në prodhim (në hektarë dhe duke iu referuar vendndodhjes së parcelës së vreshtit); sasinë e rrushit të vjelë (në 100

kg); destinacionin e rrushit (në hektolitra ose 100 kg).

Për sa u përket sipërfaqeve të mbjella me vreshta, do të kryhen kontrolle nga institucioni përgjegjës për regjistrin e

vreshtave me qëllim mbajtjen e një regjistri të përditësuar. Rregullorja parashikon edhe sanksione administrative për përfaqësuesit e sektorit që nuk e zbatojnë atë.



BUJQËSIA

Nga gjeli i detit te vera, sa shtrenjtë po kushton tryeza e Vitit të Ri?

Për shumicën e familjeve shqiptare, darka e Vitit të Ri mbetet një ritual i lidhur fort me traditën dhe tryezën e bollshme.

Menuja klasike përfshin sallata të ndryshme, mishra,

ndryshojë, por mbetet gjithësi-pesha kryesore në buxhetin e darkës.

Edhe ëmbëlsirat zënë një vend të rëndësishëm në tryezën festive. Bakllavaja, e përgatitur në shtëpi ose e blerë

të preferuar, veçanërisht në qytetet e mëdha. Kjo zgjedhje lidhet jo vetëm me dëshirën për të shmangur angazhimin dhe stresin e përgatitjeve në shtëpi, por edhe me ofertën e gjerë të argëtimit që restorantet ofrojnë gjatë natës festive. Megjithatë, ky komoditet vjen me një kosto dukshëm më të lartë, duke e bërë festimin jashtë shtëpisë një barrë të ndjeshme për buxhetin familjar.

Në ditët e zakonshme, një restorant standard i nivelit të mesëm në Shqipëri ofron një darkë për dy persona, me antipastë, pjatë kryesore dhe ëmbëlsirë, me një kosto që varion nga 4,000 deri në 8,000 lekë, në varësi të menusë dhe vendndodhjes së lokalit. Këto çmime përfaqësojnë mesatarin e tregut dhe janë relativisht të përballueshme për një dalje sporadike. Megjithatë, gjatë natës së Vitit të Ri, këto tarifa ndryshojnë ndjeshëm, pasi restorantet aplikojnë çmime speciale festive për shkak të kërkesës së lartë dhe shërbimeve shtesë që ofrohen.

Në këtë periudhë, shumica e restoranteve funksionojnë me paketa të mbyllura feste, ku çmimi për person përfshin një menu të përcaktuar paraprakisht, pije, muzikë live ose DJ, si edhe dekorime festive. Çmimet e këtyre paketave zakonisht nisin nga rreth 50 euro për person në restorantet e kategorisë mesatare dhe mund të arrijnë deri në 90–120 euro për person në ambiente më luksoze, hotele apo restorante të njohura në qendrat urbane dhe zonat turistike. Në shumë raste, pijet premium, shampanja apo shërbime të tjera ekstra tarifohen veçmas, duke e rritur edhe më shumë faturën finale.

Për një familje me katër anëtarë, zgjedhja për të festuar Vitin e Ri në restorant përkthehet në një shpenzim total prej 30,000 deri mbi 60,000 lekë, pa përfshirë shpenzime shtesë si transporti apo konsumi pas mesnate.

Dallimet në çmime janë të dukshme edhe sipas zonave gjeografike. Në Tiranë, Durrës apo qytetet turistike, çmimet e paketave festive janë përgjithësisht më të larta, ndërsa në qytetet më të vogla restorantet ofrojnë alternativa disi më ekonomike, megjithëse edhe aty vihet re një rritje e ndjeshme e tarifave gjatë natës së Vitit të Ri.

Kostoja e lartë e paketave festive reflekton jo vetëm shpenzimet e restoranteve, por edhe realitetin ekonomik të një tregu ku kërkesa sezonale rrit ndjeshëm çmimet, duke e bërë natën e Vitit të Ri një nga mbrëmjet më të shtrenjta të vitit për konsumatorët.

"Monitor"



gjeli apo pula deti me përshesh, ëmbëlsira tradicionale dhe pije alkoolike e joalkoolike. Megjithatë, përgatitja e kësaj darke në shtëpi kërkon një angazhim financiar gjithnjë e më të ndjeshëm, për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore gjatë gjithë vitit dhe veçanërisht në periudhën e fundvitit.

Sipas një vlerësimi mesatar të tregut, një familje prej katër anëtarësh shpenzon rreth 19,000–20,000 lekë vetëm për përbërësit kryesorë të darkës festive. Një pjesë e konsiderueshme e këtij buxheti shkon për sallatat tradicionale, të cilat përfshijnë produkte bazë si perime të freskëta, majonezë, vaj, vezë dhe produkte të konservuara, me një kosto që mund të arrijë rreth 2,000 lekë. Edhe pse duken shpenzime të vogla në dukje, rritja e çmimeve të perimeve dhe vajit ushqimor i ka bërë sallatat më të kushtueshme krahasuar me vitet e kaluara.

Një tjetër zë i rëndësishëm janë mishrat dhe produktet e bulmetit. Përfshirja e mishit të viçit ose të derri, sallameve, proshutës dhe djathërave për tryezën festive përkthehet në një shpenzim mesatar prej 3,300 lekësh, një nivel që reflekton rritjen e vazhdueshme të çmimeve të mishit dhe produkteve të përpunuara. Familjet që zgjedhin produkte vendase arrijnë të ulin disi koston, ndërsa ato që preferojnë produkte të importuara përballen me çmime ndjeshëm më të larta.

Zëri më i kushtueshëm i darkës tradicionale mbetet gjeldeti i detit dhe përseshi, që konsiderohet pjata simbol e Vitit të Ri. Çmimi i gjeldetit, sidomos në ditët e fundit të dhjetorit, pëson rritje për shkak të kërkesës së lartë, duke bërë që së bashku me përbërësit e përseshit, kostoja të arrijë rreth 7,500 lekë. Për familjet që zgjedhin gjeldeti vendas apo alternativat e mishit të importuar, kjo shifër mund të

në pasticeri, së bashku me ëmbëlsira të tjera tradicionale, kërkon një shpenzim prej rreth 3,000 lekësh. Rritja e çmimeve të arrave, sheqerit dhe gjalpës ka ndikuar drejtpërdrejt në koston e kësaj pjese të menisë, duke e bërë më të shtrenjtë krahasuar me vitet e mëparshme.

Në fund, pijet përbëjnë një tjetër zë të rëndësishëm të shpenzimeve. Vera, rakia, pijet freskuese dhe lëngjet për fëmijët arrijnë mesatarisht rreth 3,500 lekë, në varësi të markës dhe origjinës. Familjet që zgjedhin pije të importuara ose sasi më të mëdha, veçanërisht për pritjen e miqve, përballen me një rritje të mëtejshme të koston totale.

Në tërësi, shumica prej 19,000–20,000 lekësh përfaqëson një vlerësim mesatar dhe minimal për një darkë tradicionale në shtëpi. Nëse tryeza pasurohet me ushqime më të shtrenjta, si peshku detar, frutat e detit apo pijet premium të importuara, kostoja mund të rritet ndjeshëm, duke e bërë darkën e Vitit të Ri një barrë reale për buxhetin e shumë familjeve shqiptare. Në këtë kontekst, festimi në shtëpi mbetet zgjedhja më ekonomike krahasuar me restorantet, por gjithsesi kërkon planifikim të kujdesshëm financiar.

Sallata e antipasta – rreth 2,000 lekë

Mishra të ndryshëm (viçi, sallam, djathë) – rreth 3,300 lekë

Gjeldeti dhe përseshi – rreth 7,500 lekë

Bakllava dhe ëmbëlsira – rreth 3,000 lekë

Pijet (verë, raki, lëngje) – rreth 3,500 lekë

Shpenzimet në restorante

Për një pjesë të konsiderueshme të shqiptarëve, festimi i natës së Vitit të Ri në restorant është kthyer në një alternativë gjithnjë e më

Nuk ndalet rënia e bujqësisë dhe industrisë, rritja po vjen nga sektorë të paqëndrueshëm

Mënyra se si po rritet Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) tregon se ekonomia po mbështetet gjithnjë e më pak

Në të njëjtën kohë, industria përpunuese po mbyll vitin e tretë të rënies.

Të dy sektorët prodhues, si



te sektorët tradicionalë prodhues dhe gjithnjë e më shumë të shërbimit, ndërsa bujqësia dhe industria vijnë të japin kontribut negativ në zgjerimin e ekonomisë.

Të dhënat e fundit nga INSTAT tregojnë se ekonomia u rrit me 3.75% në tremujorin e tretë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, teksa sektori i bujqësisë ra me -1.73% në të njëjtën periudhë dhe industria ra me -4.7%.

Bujqësia po shfaq një rënie të vazhdueshme të vlerës së shtuar që nga viti 2021, duke reflektuar probleme strukturore që lidhen me fragmentimin e tokës, produktivitetin e ulët, mungesën e subvencioneve dhe presionet nga kostot.

bujqësia dhe industria kanë pasur peshë të konsiderueshme në punësim dhe ekonominë totale.

Të dyja së-bashku bujqësia dhe industria kontribuan vetëm me 23% të PBB-së në vitin 2024 nga 27.3% që ishte pesha e tyre në vitin 2019.

Kjo ecuri tregon se zgjerimi ekonomik nuk po shoqërohet me forcim të kapaciteteve prodhuese. Industria nxjerrëse dhe përpunuese po ndikohet si nga kërkesa e dobët e jashtme, ashtu edhe nga kosto më të larta në vend, mungesa e fuqisë punëtore.

Sakaq, rritja ekonomike po mbahet gjallë kryesisht nga sektorët e shërbimeve, si administrata publike, aktivitetet profesionale, financiare dhe

disa segmente të tregtisë e shërbimeve të lidhura me turizmin.


Sipas ekspertëve kjo e bën rritjen më pak të balancuar dhe më të ndjeshme ndaj goditjeve pasi mungon mbështetja nga sektorët që krijojnë vlerë të shtuar afatgjatë dhe që janë baza e eksporteve.

Të dhënat e fundit mbi PBB tregojnë se rritja mbështetet mbi baza të brishta. Rënia e bujqësisë dhe dobësimi i industrisë ngrenë pikëpyetje mbi cilësinë e rritjes dhe aftësinë e ekonomisë për të gjeneruar zhvillim të qëndrueshëm, punësim produktiv.

Rënia e prodhimit të thotë gjithashtu se ekonomia po humbet aftësinë për të konkurruar në tregjet e jashtme. Eksportet kanë pësuar rënie vjetore me rreth 7% në 11 muajt dhe mbeten të përqendruara në produkte me vlerë të ulët të shtuar, duke e bërë rritjen më të varur nga importet dhe nga flukset e jashtme, si remitancat apo turizmi. Kjo e thellon deficitin tregtar dhe e bën ekonominë më të ekspozuar ndaj goditjeve të jashtme.

Nga ana tjetër sektori i prodhimit zakonisht ofron punë më të qëndrueshme dhe me potencial për rritje aftësish. Më rënien e prodhimit punësimi zhvendoset drejt aktiviteteve më informale ose me produktivitet të ulët.

"Monitor"



AZHBR: Nuk janë kryer pagesa për kontrata të kontestuar

(Vijon nga faqja 6)

Por, theksoi AZHBR, subjekti i kontraktuar është refuzuar në fazën e pagesës, pasi nuk ka përmbyllur kushtet e kontratës së grantit.

“Megjithatë, në fazën e pagesës, subjekti i kontraktuar në fjalë, është refuzuar pasi nuk ka përmbyllur kushtet e përcaktuara në kontratën e grantit”, bën të ditur AZHBR.

AZHBR garanton fermerët dhe qytetarët se çdo proces

zhvillohet me transparencë, përgjegjësi dhe sipas legjislacionit në fuqi, duke respek-

tuar të gjitha detyrimet ligjore. Agjencia mbetet e hapur për çdo sqarim të mëtejshëm.



Kalendari i Panaireve Ndërkombëtare - Viti 2026

